




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. 2-D/DPK
Nr. i faq _____
Broj stranica _____
Nr. pages 02

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. 01-2572/12
Data _____
Datum 25-07-2012

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **27.06.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4773/11, për z. *Sabri Sadiku* – Prodekan i Fakultetit të Xehtarisë-Universiteti i Prishtinës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4773/11, për Zyrtarin e lartë, z. Sabri Sadiku – Prodekan i Fakulteti të Xehtarisë në Mitrovicë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në ndërrmarjen private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të konfliktit të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, prandaj, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. Sabri Sadiku, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyrën e shmangies së saj.

Pas këtij takimi, zyrtari i lartë, z. Sadiku, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, me informacionet mbi biznesin "Business of Kosovo" Sh.p.k., në të cilat shihet se ky zyrtar i lartë ka heq dorë nga çdo funksioni në këtë biznes privat. Dokumenti ka numer protokoli DPK/DPKI 03-1021/2012.

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

